




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

Njësia e Prokurimit

Gjilan, me datë: 01.06.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjilanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **30.05.2023**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **FORTESA sh.p.k.** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Mirëmbajtja e rrugëve të rendit të tretë me Zhavor” me Nr. të Prok: 651-23-2383-2-1-1**, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet e pabazuar Kërkesa për rishqyrtim e Operatori Ekonomik "FORTESA" sh.p.k me seli në Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Mirëmbajtja e rrugëve të rendit të tretë me Zhavor” me Nr. të Prok: 651-23-2383-2-1-1**, kundër Njoftimit për Vendimin e AK-së, të datës : 25.05.2023, si palë pa interes juridik material, konform nenit 4, paragrafi 1.26 të LPP-së.

1. **AK – Komuna e Gjilanit vendosë të vazhdojë sipas Njoftimit të AK-së dhe letrave standarde të datës 25.05.2023.**
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <http://e-prokurimi.rks-gov.net>

Ar sy e t i m

Operatori ekonomik "FORTESA" sh.p.k si palë e pakënaqur me datë 30.05.2023 ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim në Autoritetin Kontraktues të Komunës së Gjilanit kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK për dhënien e kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja e rrugëve të rendit të tretë me Zhavor" me Nr. të Prok: 651-23-2383-2-1-1 me pretendimin se AK ka vepruar në kundërshtim me nenet 1, 59 dhe 61 të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjilanit, pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim, ka shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve ankimore, të paraqitura në kërkesën për ri-shqyrtim të OE "FORTESA" sh.p.k, me seli në Prizren. Në zbatim të Ligjit nr.04/L-042 të LPP-së (i konsoliduar), lidhur me nenin 62 dhe 63 të Rregullorës për Prokurim Publik, nr.001/2022, zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, pas shqyrtimit meritore të pretendimeve ankimore të përfshira në kërkesën e OE ankues kundrejt vendimit të AK-së për dhënien e kontratës OE EL BAU Sh.p.k., dhe sipas vlerësimit të gjitha fakteve tjera dhe shkresave të lëndës, vjen në këtë përfundim:

Se kërkesa për rishqyrtim e OE ankues në të gjitha pretendimet është e pabazuar dhe pa ndikim për vendosje ndryshe. Ashtu që rezulton se procesi i vlerësimit është zhvilluar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme sipas vlerësimit të pavarur dhe konform nenit 59.4, nenit 61 dhe nenit 60 paragrafi 1.1 të LPP-së.

Duke u bazuar në përmbajtjen dhe thëniet e kërkesës për rishqyrtim, të gjitha pretendimet ankimore i referohen një objekti ankimor që lidhet me pretendimin se tenderi i OE të rekomanduar me kontratë sipas ankuesit është tender jo-normalisht i ulët. Prandaj AK, pasi që ka vlerësuar përmbajtjen e të gjithave pretendimeve, duke u bazuar në fakte dhe prova konkrete ju përgjigjemi si më poshtë:

Së pari, OE ankues pretendon se AK Zyra e Prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 61 të LPP-së dhe nenin 41 Rregullorës për Prokurim Publik duke vënë në pikpyetje se dhënia e kontratës për OE të rekomanduar është bërë edhe në kundërshtim me nenin 59.4 dhe nenin 60 të LPP-së. Mirëpo, ankuesi nuk ka arritur të argumentojë dhe plotësojë arsyetimin e tij me prova relevante konform situatës faktike dhe dispozitave ligjore të zbatueshme në rastin konkret.

Mënyra e paraqitjes se AK paska vepruar në kundërshtim me dispozitat e lartshënuara nuk qëndron e bazuar në gjendjen faktike dhe në dispozitat e zbatueshme në rastin konkret sepse paraqitet pasqyrim i gabuar i gjendjes faktike që nuk përkon me realitetin në pikpamje faktike dhe ligjore. Autoriteti Kontraktues, respektivisht komisioni i vlerësimit gjatë vlerësimit të tenderëve, respektivisht aplikimit të procedurës për sqarimin e tenderëve, ka vepruar në bazë të vlerësimit dhe diskrecionit të lirë në pajtueshmëri të plotë me dispozitat ligjore të nenit 61 të LPP-së dhe nenit 41 të Rregullorës Nr.001/2022 karrshi OE që komisioni kishte vlerësuar se tenderët e tyre duken jo normalisht të ulët. Sipas nenit 41 paragrafi 4 të Rregullorës për Prokurim Publik Nr.001/2022 përcaktohet shumë qartë se kur një tender konsiderohet si jo normalisht i ulët në pajtim me Nenin 61 të LPP dhe paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore, një tender i tillë nuk mund të refuzohet pa hetimin dhe shqyrtimin e elementeve të rëndësishme që shkaktojnë tenderin veçanërisht të ulët.

Në këtë kuptim AK duke vepruar sipas rregullave të procedurës dhe sipas vlerësimit të lirë të komisionit vlerësues ka kërkuar sqarimin e tenderëve që ka vlerësuar se janë dukur si jo-normalisht

të ulët. Kërkesa e AK-së nuk është obligative, është vullneti i lirë i OE se a dëshirojnë apo jo ti përgjigjen kërkesës së AK-së. Lidhur me OE Pro-Co Group, autoriteti kontraktues nuk ka pranuar asnjë shpjegim pasi që i njëjti nuk ka shprehur gatishmëri të përgjigjet dhe në këtë mënyrë tenderi i tij është refuzuar. Prandaj AK e konsideron paragjykes pretendimin ankimor sa i përket OE në fjalë. Nga ana tjetër OE EL Bau i cili në rastin konkret është rekomanduar me dhënien e kontratës është përgjegjur duke i paraqitur sqarimet e nevojshme e të cilat i ka argumentuar me dëshmi bindëse në lidhje me elementet përbërëse të tenderit dhe rrjedhimisht bazën e tenderit. Në këtë mënyrë sqarimet e OE në fjalë të mbështetura me prova konkrete janë vlerësuar të besueshme dhe të bindshme për AK-në duke marrë në konsideratë edhe kriteret e përcaktuara në nenin 61 paragrafi 2, nënparagrafi 1, 2,3 dhe 4 të LPP-ës dhe nenin 41.8 të RRPP Nr. 001/2022, ku përcaktohet në mënyrë të qartë se nga ana e AK-së duhet të mirren parasysht shpjegimet në lidhje me:

- *ekonominë e procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit;*
- *çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur;*
- *çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose*
- *originalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara.*

Për më tepër që AK-ja të sigurohet se projekti do të ekzekutohet në përpikmëri me paramasën dhe paralogarinë si dhe me cilësi sipas normave të ndërtimit, ka kërkuar nga OE në fjalë që ta ngrisë sigurimin ekzekutimit nga 10% në 20% e cila siguron AK-në dhe mjafton për ti mbuluar dëmet në rast se mund të ndodhin gjatë ekzekutimit të kontratës apo shkëputjes së kontratës. Operatori Ekonomik i rekomanduar me dhënien e kontratës e ka kthyer përgjigjen përmes deklaratës me shkrim ku është pajtuar ta bëjë sigurimin e ekzekutimit sipas kërkesë AK-së. Dhe në këtë kuptim ka vlerësuar dhe besuar se tenderi i OE të rekomanduar është i zbatueshëm dhe realizueshëm në pajtueshmëri me paramasën dhe paralogarinë dhe të gjitha mekanizmat tjerë të sigurisë dhe standardeve të ndërtimit.

Prandaj, bazuar në shpjegimin e situatës faktike më lartë, rezulton se procedura është zhvilluar në pajtueshmëri të plotë me kërkesat ligjore, kështu që pretendimi i OE ankues është i pabazur pasi që si i tillë paraqet hamendsime dhe supozime të pabaza që nuk përkojnë me realitetin dhe me gjendjen faktike.

Lidhur me supozimet e analogjisë për të krahasuar çmimet e këtij aktiviteti me aktivitete tjera, AK vlerëson se kjo analogji është e paqëndrueshme për shkakun se secili aktivitet ndryshon për nga rrethanat, forma dhe objekti i projektit sikurse rasti konkret ku kemi të bëjmë me një kontratë të shërbimeve – mirëmbajtje. Për më tepër sipas legjislacionit në fuqi, ekonomia e tregut me konkurrencë të lirë është bazë e rregullimit ekonomik të Republikës së Kosovës. Në këtë kuptim, palët janë të lirë që në bazë të pajtueshmërisë dhe vullnetit të tyre ti përcaktojnë ofertat e tyre e po ashtu lidhjen e kontratave të bashkpunimit pa pasur nevojë pëlqimin e një pale të tretë.

Prandaj, marrëveshjet e dorëzuara nga ana e OE të rekomanduar me dhënien e kontratës i ka lidhur me dy subjekte komerciale N.P.T BESHI COM dhe EKEN BETON Sh.p.k., AK vlerëson se këto marrëveshje i plotësojnë të gjitha kushtet ligjore sipas Ligjit të Marrëdhënieve Detyrimore Nr. 04/L-77 ngase janë lidhur ndërmjet dy subjekteve afariste të përcaktuara me ligj ku palët sipas vullnetit dhe interesit të lirë të tyre afarist janë pajtuar për elementet thelbësore të kontratës. Në

rastin konkret sipas kontratës kemi të bëjmë me një bashkpunim afatgjatë ndërmjet furnitorëve me OE e rekomanduar me dhënien e kontratës, kurse nga ana e furnitorëve është paraqitur një ofertë me propozim konkret pa përjashtime e cila ka qenë e pranueshme për OE e rekomanduar me dhënie dhe në këtë kuptim janë lidhur marrëveshjet të cilat i përmbajnë të gjitha elementet thelbësore të një marrëveshje me shkrim. Furnitori është i lidhur me ofertën që ju ka bërë OE të rekomanduar me dhënien e kontratës. Për më tepër marrëveshjet e prezentuara nga ana e OE të rekomanduar me dhënien e kontratës janë noteriyuar përkundërse në dosje nuk ka pasur një kërkesë të tillë, mirëpo kjo është bërë sipas vullnetit të OE në fjalë dhe kjo rrethanë është në favor AK-në sepse një dokument me akt noterial paraqet besueshmëri më të plotë.

Gjithashtu analiza e juaj krahasimore duke i krahasuar çmimet e këtyre marrëveshjeve me oferta të ndryshme që janë paraqitur nga ana e juaj nuk është krahasim as objektiv dhe as real apo i lejshëm sepse bashkëpunimi dhe mënyra e përcaktimit të çmimeve me njëri tjetrin është vullnet i lirë i palëve se si ato vlerësojnë të ofrojnë një ofertë për një furnitorë të caktuar apo një furnitorë tjetër me të cilin kanë bashkëpunim afatgjatë. Nuk ka asnjë detyrim ligjor që e kufizon dhe kornizon ofertën në mënyrën e përcaktimit të çmimeve të ofruara. Oferta e çmimeve është propozim për lidhjen e kontratës që i bëhet personit të caktuar kështu që është në vullnetin e lirë të kërkuarit të ofertës se a është e pranueshme. Në kuptim faktik dhe ligjor, ekonomia e tregut me konkurrencë të lirë është bazë e rregullimit ekonomik të Republikës së Kosovës dhe ne si AK nuk kemi asnjë të drejtë që të ndërhyjmë apo kufizojmë konkurrencën apo të rregullojmë tregun.

Në këtë mënyrë, AK vlerëson se është i pabazuar vlerësimi i juaj se me ofertën e rekomanduar për dhënien e kontratës rrezikohen parametrat, cilësia dhe ekzekutimi i kontratës. Përkundrazi, duke marrë për bazë të gjitha faktet relevante dhe masat e ndërmarrë nga AK-ja, AK-ja sipas gjykimit të saj të lirë dhe objektiv vlerëson se oferta e OE të rekomanduar me dhënien e kontratës për AK-në është e pranueshme, e besueshme dhe bindëse. Për ta fuqizuar akoma më shumë këtë vlerësim, AK-ja ka kërkuar nga OE në fjalë që ta ngrisë sigurimin ekzekutimit nga 10% në 20% e cila siguron AK-në dhe mjafton për ti mbuluar dëmet në rast se mund të ndodhin gjatë ekzekutimit të kontratës apo shkëputjes së kontratës. Operatori Ekonomik i rekomanduar me dhënien e kontratës është pajtuar ta bëjë sigurimin e ekzekutimit sipas kërkesë AK-së. Për më tepër, OE në fjalë në vazhdimësi ka pasur kontrata me AK-në të cilat i ka realizuar sipas kushteve të kontratës me cilësi sipas standardeve të ndërtimit dhe në afatin e parashikuar. Sa i përket pohimit ku i referoheni një vendimi të OSHP-së, AK vlerëson se nuk vlerësimin nuk e bazon në praktika çfaredo qofshin ato mirëpo në kërkesa ligjore, sepse nga ana tjetër ka edhe shumë vendime tjera të OSHP-së që përkitazi me çështje të ngjashme është vendosur në favor të vlerësimit dhe diskrecionit të AK-së.

Sa i përket pohimeve ku jeni thirrur në çmime referente të KRPP-së pa arritur që këtë pretendim ta argumentoni me fakte konkrete, AK vlerëson se mënyra e paraqitur nga ana e juaj nuk qëndron e bazuar por si e tillë bazohet në supozime të pabaza për ta ngatërruar gjendjen faktike. E vërteta është se çmimet referente janë opcionale dhe jo obligative për OE dhe për institucionet publike. Për më tepër lista e produkteve të shërbimeve me çmime referente nuk i ka përfshirë të gjithë produktet dhe shërbimet dhe nuk është përditësuar për një periudhë të gjatë kohore duke i bërë ato jo valide. Gjithashtu as me dispozitën e nenit 61 të LPP-së nuk është përcaktuar dhe kufizuar një tavan minimal i çmimeve, mirëpo në paragrafin 2 të kësaj dispozite janë përcaktuar kriteret që duhet të mirren parasysh nga ana e AK-së ashtu edhe siç kemi vepruar.

Ndërsa në nenin 1 dhe nenin 6 të LPP-së përcaktohet se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë mënyrën më efikase dhe më transparente ashtu që fondet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Lidhur me këtë, në nenin 4 paragrafi 1 të Rregullorës Nr.001/2022, përcaktohet se autoritetet kontraktuese gjatë administrimit të procedurave të prokurimit duhet të sigurohen që mos të kontraktojnë çmime më të larta se çmimet e tregut.

Sa i përket pretendimit lidhur OE Agro Invest Sh.p.k. & Lord Group Sh.p.k., paneli vlerëson të mos lëshohet në shqyrtim lëndor të këtij pretendimi për shkak se i njëjti është nuk mund të konsiderohet si palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafi 1.26 të LPP-së, dhe në kuptim gjendja faktike nuk ndryshon dhe nuk ka bazë për të vendosur ndryshe nga ajo që është vërtetuar gjatë procedurës së vlerësimit përfundimtar me Njoftim Vendimin e AK-së të datës 25.05.2023.

Përfundim

Autoriteti Kontraktues pas shqyrtimit meritor të gjitha pretendimeve të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim të OE FORTESA Sh.p.k., dhe duke u bazuar në analizën e të gjitha fakteve dhe shkresat e kësaj lënde, sipas vlerësimit të pavarur dhe objektiv vlerëson se procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve është zhvilluar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe zbatimit të drejtë të nenit 59.4, nenit 60 paragrafi 1.1, nenit 61 lidhur me nenin 1, 6 dhe 7 të LPP-së.


Andaj si rezultat i vlerësimit të drejtë dhe të ligjshëm AK ka ardhur në përfundim se tenderi i dorëzuar nga OE "EL-BAU" sh.p.k. është i përgjegjshëm pasi i ka plotësuar në tërësi të gjitha kriteret e përzgjedhjes të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe dosjen e tenderit si dhe e ka plotësuar kriterin kryesor për dhënie të kontratës si tender i përgjegjshëm me çmim më të ulët. Prandaj të gjitha këto arsye dhe fakte të argumentuara japin bazë të mjaftueshme se pretendimet e parashtruesit të kërkesës janë të pabazuara.

Andaj duke u bazuar në arsyeshmërinë ligjore dhe të fakteve të cekura më lartë, Autoriteti Kontraktues përmes Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-së duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendi**

Shqipe Hoxha


Zyrtare Përgjegjëse e Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;